




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punë se Kuvendit, si dhe ne pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu:

T H Ē R R E T

Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj, e cila do të mbahet me datë 27.11.2024, (ditë e mërkure), me fillim prej orën 10:00, në Sallën e Kuvendit

Mbledhja do të ketë këtë:
REND DITE

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Informata nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambientit, me Nr.06.351/01-0052104/24, i datës 13.11.2024, (Raporton drejtori i DUMA-së, **z. Driton Mulaj**);
5. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.


KRYESUESJA E KUVENDIT

znj. Adelina Spahiu





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ, i datës 30.10.2024, ora 10:00.

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Shqyrtimi i raportit financiar i realizimit të buxhetit komunal janar-shtator 2024, me Nr.04-052/01-0048205/24, i datës 10.10.2024, (Raporton drejtori i DBF-së, **z.Ismet Aliu**);
5. Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar i hartuar nga komisioni komunal, për demet të shkaktuar nga zjarret, era, breshëri dhe fatkeqësitë tjera për muajin Korrik-Shtator 2024, me Nr.09-325/04-0048367/24, i datës 11.10.2024, (Raporton drejtori i DSHP-së, **z.Alban Shala**);
Pikat shtesë
6. Propozim-vendimit, për ngritjen e planit të të hyrave vetanake për vitin 2024 të Komunës së Skenderajt, më Nr.04-400/01-0050330/24, i datës 30.10.2024, (Raporton drejtori i DBF-së, **z.Ismet Aliu**);
7. Informatë lidhur me muajin e solidaritetit 01-31 Tetor 2024, (Raportoj anëtarja vullnetare e Kryqit të Kuqë, Dega në Skenderaj)
8. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu: I nderuar kryetar i komunës Fadil Nura, të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, dhe gjithë ju të pranishëm, shkojmë në konstatime të kuorumit në sallë janë 28 anëtar, mungon me arsye Osman Smajli, Arjeta Rama, ndërsa bashkëngjitet gjate seance Sala Jashari.

Para miratimit të rendit ditës i kemi dy pika shtesë:

-Propozim-vendimit, për ngritjen e planit të të hyrave vetanake për vitin 2024 të Komunës së Skenderajt, më Nr.04-400/01-0050330/24, i datës 30.10.2024,

-Informatë lidhur me muajin e solidaritetit 01-31 Tetor 2024,

Shkojmë në votim për së cilën veç e veç për futjen në rend dite:

Vazhdojmë me piken e parë: Konstatojmë me (17) vota për, (10) kundër dhe (0) abstenim, futet në rend dite Propozim-vendimit, për ngritjen e planit të të hyrave vetanake për vitin 2024 të Komunës së Skenderajt, më Nr.04-400/01-0050330/24, i datës 30.10.2024.

Vazhdojmë me piket e dytë: Konstatojmë me (17) vota për, (0) kundër dhe (10) abstenim, futet në rend dite Informatë lidhur me muajin e solidaritetit 01-31 Tetor 2024.

Shkojmë me miratimin e rendit ditës, e hap debatin, nëse nuk ka konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër dhe (10) abstenim, Miratohet rendi i ditës.

Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës,

-Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara, e hapë debatin, nëse nuk ka shkojmë në votim; Sala Jashari, është bashkangjitur mbledhjes;

Konstatohet me (29) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës;

-Shqyrtimi i raportit financiar i realizimit të buxhetit komunal janar-shtator 2024, me Nr.04-052/01-0048205/24, i datës 10.10.2024, (Raporton);

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu; Fjala përshëndetëse, para vetes e keni raportin financiar i realizimit të buxhetit komunal janar-shtator 2024, është raporti i tret i rregullt sipas ligjit në fuqi, ndryshimet që kanë ndodhur nga buxheti fillestar gjatë vitit aktual buxheti është 19,529,778.83€, në këtë buxhet janë shtua të hyrat të bartura nga viti paraprak në këtë tre mujorin e fundit që është edhe grandit i performancës prej 603,370.00€, pjesë përbërës e këtij buxheti, pjesë përbërës janë edhe të hyrat vetanake që janë realizuar në një përqindje prej 93.85%. karakteristik kryesore e këtij raporti janë gjitha të hyrat komunale që janë realizuar në këtë 9 mujor, që janë alokuar në buxhet sipas planit buxhetor, dhe gjitha mjetet e shpenzuar nga tre mujoret paraprakë janë bartur në tre mujorin e fundit për shpenzim. Me vendime gjyqësore në emër të shujtave, licencimit inflacionit janë ekzekutuar 2,208,473.72€ nga departamenti i thesarit. Grandit qeveritar është 88.50%, Të hyrat Komunale 8.42% dhe Donacionet me Demosin në 3.09%. Të hyrat që janë realizua në përqindje të madhe janë nga lejet e ndërtimit nga tatimi në pronë. Pagat dhe shtesat kanë shënuar rritje ne krahasim me vitin 2023 për 26.55 %, dhe një rritje e tillë është e ndikuar nga vendimet gjyqësorë/përmbartimore , pjesëmarrja e pagave ne shpenzimet e përgjithshëm komunale për periudhën janar- shtator 2024 është 56.13 %. Mallrat dhe shërbimet kanë pasur rritje prej 22.62% ne krahasim me vitin 2023, kurse pjesëmarrja e tyre ne shpenzimet e përgjithshme është 11.28 %. Rënie te konsiderueshme ka pas te nënkategoria: mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, furnizime për zyre, kompensimi i përfaq. brenda vendit etj. Rritje të konsiderueshme ka pasur te nënkategoria: mirëmbajtja e ndërtesave arsimore, mirëmbajtja e objekteve shëndetësore, drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje por edhe ndikimi nga vendimet gjyqësore/ përmbartimore. Shërbimet komunale kanë pësuar rritje prej 3.82 %, kurse ne shpenzimet e përgjithshme marrin pjesë me 1.37 %. Subvencionet dhe transferet kane shënuar rritje prej 26.33 %, janë subvencionuar kryesisht programet për bujqësi, pagesa te këtij viti për Bashkësinë Islame, pagesa për fëmijët e porsalindur, raste te trajtimeve shëndetësore, financimi i bursave për studente, përkrahja ne fushën e kulturës rinise dhe sportit (mbësh. e klubeve sportive), përkrahja e bizneseve te vogla dhe te mesme me garantë sipas planeve te tyre bizneseve. etj. Ne shpenzimet e përgjithshme subvencionet marrin pjesë me 5.59 %. Shpenzimet Kapitale kanë shënuar rritje për 54.69 % , ndërsa ne shpenzimet e përgjithshme komunale marrin pjesë më 25.63 %. Ne përgjithësi shpenzimet e gjithmbarshme komunale janar-shtator 2024 janë për 27.56 % ma të larta së ato për periudhën e njëjta ne vitin 2023. Ne shpenzimin e buxhetit për periudhën raportuese ka përfitua edhe gjinia femërorë neper te gjitha kategoritë. Në faqen 8 është analitika e shpenzimit të buxhetit e krahasuar me dy vitet paraprake të njëjtës periudhë, dhe në fund janë shpenzimet sipas drejtorive dhe zyrave.

Kryesuesja; E hap debatin, fjalën ja kaloj:

Afrim Kabashi-NSD: Fjala përshëndetëse, drejtor kam disa pyetje për disa shqetësime qe kam hasur gjate leximit tek llojet e shpenzimeve, dhe nëse mundesh me na sqarua për llojet e shpenzimeve ne këto kategori. Tek kodi 13440 shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënës nuk po dua te ndalem qe ne vitin 2021 nuk kemi pasur fare shpenzime, ne vitin 2022 i kemi pasur 7033.75€, ne vitin 2023 kemi shpenzime 2750 €, ndërsa ne këtë vite d.m.th. 2024 kemi shpenzime 12,417€, a mundesh te na sqarosh, çka përfshin dhe për çka është fjala kjo

rritje e këtyre shpenzimeve ne këtë mase. Tek kodi 13445 shërbime te veçanta konsulentë dhe kontrakto individual ne dy vitet paraprake 2022-2023 fare shpenzime ne vitin 2024 për këtë periudhe kohore shpenzime 5970.10 €. A ka mundësi te njoftohemi për çfarë shërbimesh të veçanta kemi te bëjmë, apo mos po paguajmë ne emër te kësaj kategorie konsulent dhe kontraktore individual persona qe rrinë në shpi. Tek kodi 13501 mobileje me pake se 1000 euro ne vitin 2022 shpenzime 4837.99 euro ne vitin 2023 5484.31 euro, ndërsa ne vitin 2024 shpenzime 30,733.77 €. Sipas shifrave te dhëna ne raport kogja mire keni bere shpenzime për mobile. Te kodi 14024 mirëmbajtja e objektiv shëndetësorë ne dy vitet paraprake kemi shpenzime minimale, ndërsa në këtë vite kemi shpenzime te larta ne shifrën 52,368.54 euro. Drejtor ne raport keni theksuar se subvencionet kanë shënuar rritje dhe se keni theksuar se janë subvencionuar kryesisht programet ne bujqësi, dhe nëse kështu kam pyetje konkrete dhe kërkoje përgjigje konkrete a kemi te bëjmë këtu me participim ne realizimin e projektit, apo su subvencionim te X projektit, dhe a ka mundësi te na njoftoni cili projekt i realizuar ne programet e bujqësisë nga komuna është subvencionuar. Unë e kam edhe pyetjet këshilltareve ku do ta cekim ma vone mundësin e subvencionimit e bujqve për mbjella vjeshtore kryesisht mbjelljen grurit.?

Floriana Halili-LVV: Fjala përshëndetëse, drejtor të tabela, Furnizimi me ushqim e pije jo dreka zyrtare, kemi diference të madhe nga vitet tjera në vitin 2024, e kemi shumen 71,666.15€. Të drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje, kemi diference të madhe prej viteve të kaluar, në këtë vite janë 126,630.00€? Mirëmbajtja e ndërtesave administrative afariste, e kemi një dallim të madh me vitet paraprake këtë vite i keni 57,990.76€? Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore për këtë vit janë 209,955.19€, një dallim i madh me vitet tjera? Dhe mirëmbajtja rutinore vitet e kaluara nuk ka pas shpenzim e këtë vite janë 108,330.57€, Drejtor a mundës me na sqarua perse këto rritje kanë ndodhur këtë vite, të këto kategori?

Hysni Mehani-LVV: Fjala përshëndetëse, drejtor po me intereson një çështje që është aktuale, qysh keni me zgjidh çështjen e pagave, sepse është lexuar neper disa portale, po edhe nëse e shohim edhe në raport këtu në vendime gjyqësore/përmbarrimorë në emër të shujtave, licensimit dhe inflacionit janë marrë prej pagave 2,208,473.72€, dhe ky është problem që është shpërfaq edhe në komunat tjera, qysh po mendoni së keni me zgjidh këtë çështje, cila është alternativa që ju e bëni?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu; Për shpenzime së përse janë me të larta disa kategori, që i ngrit, ne duhet me ditë së buxheti në krahasim me vitin paraprak gjithnjë është me i lartë neper të gjitha kategori dhe për atë edhe shpenzimet janë me të larta nëpër disa kode. Të kodi 13440 shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënës, ky shpenzim është regjistruar për pjesëmarrje një anëtar i shoqërisë civile në konkurse, të komiteti i auditimit, disa anëtar që kanë marr pjesë në komisione që kanë ndodh neper fatkeqësi natyrore. Mirëmbajtja e ndërtesave afariste, është shpenzim për ngjyrosjen e brendshme të objektit të komunës, mirëmbajtja dhe pastrimi i komunës, dritat lled të objektit të komunës. Shpenzimet rutinore janë shpenzime për mirëmbajtje të hapësirave publike si kanalizim, ndriçimit publik, druajt dekorativ. Shërbimet e veçanta konsulent janë shpenzime të paguara për përmbarrues privat. Subvencione janë kryesisht të paguar në programe në bujqësi, pagesa për bashkësi islame, për fëmijët e porsalindur, bursa për student, ndërsa participimi nuk është subvencion ajo është e hyrë vetananake. Për vendime gjyqësore janë ekzekutuar 2,208,473.72€, dhe nuk janë ekzekutuar të gjitha nga kategoria e pagave, po janë ekzekutuar edhe nga kategoritë tjera dhe mundeni mi pa në faqen 8. Dhe do të kemi problem për paga në fund të vitit që është një problem nëpër të gjitha komunat, dhe tani për tani nuk dua të dha një përgjigje të qëndrueshme, për arsye janë në zhvillim të sipër proceset sa i përket kësaj çështje. Sepse komuna kur ka shpenzime të paplanifikuara ka të drejtë me informua ministrin e financave e me kërkuar

mjete shtesë, dhe ne kemi kërkuar dhe nuk kemi marr ende përgjigje, dhe deri sa nuk kemi përgjigje nga ministria, nuk do të dha një përgjigje tjetër, sepse këto shpenzime kanë dal të paplanifikuara, dhe nuk kemi pas të drejt me planifikua për vitin aktual.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (18) vota për, (10) kundër dhe (0) abstenim përkratet Shqyrtimi i raportit financiar i realizimit të buxhetit komunal janar-shtator 2024, me Nr.04-052/01-0048205/24, i datës 10.10.2024.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar i hartuar nga komisioni komunal, për demet të shkaktuar nga zjarret, era, breshëri dhe fatkeqësitë tjera për muajin Korrik-Shtator 2024, me Nr.09-325/04-0048367/24, i datës 11.10.2024, (Raporton);

Drejtori i DSHP-së, Alban Shala; Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar i hartuar nga komisioni komunal, për demet të shkaktuar nga zjarret, era, breshëri dhe fatkeqësitë tjera për muajin Korrik-Shtator 2024, që ka konstatuar dëme në bujqësi 51 raste, në ekonomi familjare 4 raste, në vlerë të përgjithshme 279.123.03€, materialin e keni para veti, me listën e personave të dëmtuar, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja; E hap debatin, fjalën ja kaloj:

Naser Bajraktari-IDEAL: Fjala përshëndetëse, e kam lexuar këtë raport dhe kam pa shumë emra dhe mbiemra të cilët në një fshatë ka pas veç të një njeri breshër e të tjerët jo, ku dihet që një numër i madh i dëmeve janë shkaktuar nga breshëri, në muaj gushtë ku temperaturat kanë qenë mbi 30 gradë, ku ka pas mundësi me qenë aj breshër. Unë po i citoj do emra vetëm me nr. rendor që ju i keni vlerësuar, Nr. 3 vlera 8,540.00€, Nr.10 vlera 22,928.00€, Nr.11 vlera 4,660.83€, Nr.13 vlera 9,217.88€, Nr.19 vlera 29,000.00€, Nr.35 që nuk shihet emri, kush është aj, dhe çka ju ka dëmtua, a keni argumente, çka ka pas të mbjella që ju ka dëmtua kjo vlera prej 49,966.01€, Nr. 39, vlera 10,000.00€, Nr.47, vlera 7.322.94€, Nr.49, vlera 6,761.66€, Në këtë raport që e keni bërë këtu, ka vend shume që është i manipuluar dhe unë këtë raport nuk mundem me votua, sepse nuk kam as një argument që janë dëmtuar këta persona.

Hysni Mehani-LVV: Drejtor krejt kjo çka është e paraqitur këtu është jo reale qysh po e thotë edhe Naseri, se me ju shkaktua dem 49 mijë euro, një personi, duhet me u rrafshua një fshatë me dëme në bujqësi, po përtej kësaj ju jeni kompetent e keni vlerësua, ama a ma sqaron këtë çka e ke nënshkruar, së vlerësimin nuk e ke bërë ti, nuk e mban përgjegjësin, dakortë; Lista e përmbledhur e vlerësimit të dëmeve pas miratimit nga asambleja do të dërgohet në komisionin qeveritar AME, për vlerësim të dëmeve. Ju në AME a po e dërgoni me ja pagua demet a me be vlerësim mbi vlerësim, sepse kjo është e paqartë si logjikë? Edhe pyetja tjetër që e kam ne e dimë ju keni dërgua edhe lista tjera ma herët, edhe keni bërë rahmet me njerëz keni thënë nuk jave qesin paret, edhe po doni me nxitë urrejtje karshi nivelit qendror, po a ka ndonjë rast që janë paguar, për vlerësimet që i keni bërë me herët? Nëse ju e shihni që ky vlerësim nuk është tu dhes, pse nuk po bëni me real që me marr seriozisht e me trajtua që këto raste me funksionua.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Drejtori i DSHP-së, Alban Shala; Naser sa i përket dyshimeve tua, ato dyshime mbesin të ti, a janë dëme apo nuk janë, janë të vlerësuar prej komisionit me prova që e kanë së cila lenden e vetë me fotografi, dhe mundeni me ardhur në zyre me i shikua. Hysni AME-ja kur ti merr lendet, në ato lende që ka dyshime mundet me i rivlerësua dhe me kërkuar prova shtesë.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Naser Bajraktari-IDEAL: Drejtor të gjithë merrem këtu me politik, po ti je ma politik, Nr.13, a është banor rezident dhe çka ju ka djeg, edhe që sa nuk është banor i ati fshati, unë po i lypj provat së çka ju ka djeg që ju ka shkaktua ky dem, kjo shumë?

Hysni Mehani-LVV: Drejtor dy pyetje që nuk mu përgjigje; A ka ndodh ndonjë herë që janë paguar këto dëme? Edhe, A i ke qu për rivlerësim apo me ti pagua demet?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Drejtori i DSHP-së, Alban Shala; Së cili emër në këtë listë është e dokumentuar me prova dhe e ka raportin e vlerësimit nga komisioni dhe e specifikon çfarë dëmi ju ka shkaktuar, materialin e keni pas me kohe para veti, ne qoftë së veç keni pas dyshime keni muajt me ardhur me shikua lendet. Hysni, qeveria nuk na ka bërë pagesën për raportet që i kemi dërguar deri me tani dhe jemi në pritje, po si do qoftë detyrën ton jemi ku e krye në bazë të ligjit për fatkeqësitë natyrore.

Kryetari i Komunës Fadil Nura; Fjala përshëndetëse, AME-ja ka autoritet mbikëqyrëse dhe e ka të drejtën e verifikimit për çdo lende, e kanë komisionin e vetë dhe me kontestua çdo rastë deri me tani prej kohës së vërshimeve, ku ka pas elemente të dyshimit edhe rastet e tilla i kanë me afate.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatohet me (18) vota për, (9) kundër dhe (2) abstenim miratohet Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar i hartuar nga komisioni komunal, për demet të shkaktuar nga zjarret, era, breshëri dhe fatkeqësitë tjera për muajin Korrik-Shtator 2024.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit të ditës,

-Propozim-vendimit, për ngritjen e planit të të hyrave vetanake për vitin 2024 të Komunës së Skenderajt, më Nr.04-400/01-0050330/24, i datës 30.10.2024, (Raporton);

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu; Propozohet ngritja e planit të të hyrave vetanake për vitin 2024 ne shume prej 585,000.00€ Këto mjete do të janë në dispozicion për të financuar aktivitete dhe projekte të reja ose ekzistuese në vitin aktual sipas të dhënave të mëposhtme si vijon:

Në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime shuma prej 136,500€, Në nën-programin Infrastruktura rrugore 18023, kodi funksional 0451 shuma prej 50,000 €, Në nën programin Shërbimet e shëndetësisë primare 74400 kodi funksional 0721 shuma 70,000 €, Në nën-programin Arsimi parashkollor 92650, kodi funksional 0911 shuma prej 16,500 €. Në kategorinë ekonomike shpenzime komunale shuma prej 35,000€ Në nën-programin Infrastruktura rrugore 18023, kodi funksional 0451 shuma prej 25,000€, Në nën programin Shërbimet e shëndetësisë primare 74400 kodi funksional 0721 shuma 10,000€. Në kategorinë ekonomike Subvencione dhe transfere shuma prej 113,500€: Në nën-programin Zyra e Kryetarit 16023, kodi funksional 0111 shuma 23,000 € Në nën-programin Infrastruktura rrugore 18023, kodi funksional 0451 shuma prej 30,000€, Në nën-programin Planifikimi i zhvillimit ekonomik 48023 kodi funksional 0411 shuma 23,000€. Në nën-programin Administrata 73032 kodi funksional 0760 shuma 22,500€. Në nën-programin Bujqësia 47023 kodi funksional 0421 shuma 15,000€. Në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale shuma prej 300,000€. Në nën-programin Planifikimi mjedisor dhe inspekcioni 66620, kodi funksional 0620 shuma prej 263,000€ në projektet si vijon: “Rregullimi i subqendrës Likocv” kodi i projektit 51209 shuma 30.072,36€, “Asfaltimi i rrugës në Lagjen 3 -Prekaz” kodi i projektit 52568 shuma 40.000,00€, “Vazhdimi i punimeve të kompleksi i UÇK-së - Objekti i U-së” kodi i projektit 52641 shuma 72.927,64€, “Unaza e brendshme 3 krahu kah Llausha” kodi i projektit 53903 shuma 40.000,00€. “Tribunat ne stadiumin e qytetit” kodi i projektit 52646 shuma 30.000,00€, “Asfaltimi, riparimi dhe kubëzimi i rrugëve në BL Likoc, Turiqevc, Runik, Qirez” kodi i projektit 54005 shuma 40.000,00€. “Kanalizimi fekal ne fshatin Kline e Ulet” kodi i projektit 90313 shuma 10.000,00€, Në nën-programin Shërbimet e shëndetësisë primare 74400, kodi funksional 0721 shuma prej 37,000 € në projektin si vijon: “Paisje mjekësore për nevojat e QKMF-së, QMF-së dhe AMF-ve” kodi i projektit 52302 shuma 37.000,00€.

Kryesuesja: E hap debatin, fjalën ja kaloj;

Hysni Mehani-LVV: Drejtor a mundet me ndikua kjo bartje që ne me pas telashe në mungesë të mjeteve për çështjen e pagave, a e rrezikon kjo atë pjesë?

Afrim Kabashi-NSD: Drejtor në kategorinë e subvencioneve Në nën-programin Bujqësia 47023 kodi funksional 0421 shuma 15,000€, çfarë përkrahjen është kjo për bujqësinë në këtë shumë e kaç të vogël prej 15,000€?

Kryesuesja: fjalën ja kaloj:

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu; Sa i përket reflektimit në paga kjo nuk reflekton në paga për arsye së ky është një plan i të hyrave vetanake që i shtohen vitit aktual dhe këto të hyra për momentin nuk janë realizuar dhe realizohen në përrudhën në vijim dhe të ishin alokuar në paga nuk do të kryheshin punë. 15,000€ euro subvencione në bujqësi ju kanë shtua drejtores shtesë.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (21) vota për, (5) kundër dhe (3) abstenim miratohet Propozim-vendimit, për ngritjen e planit të të hyrave vetanake për vitin 2024 të Komunës së Skenderajt.

Vazhdojmë me piken 7 të rendit të ditës,

-Informatë lidhur me muajin e solidaritetit 01-31 Tetor 2024, (Raportoj);

Anëtarja vullnetare e Kryqit të Kuqë, Dega në Skenderaj; Fjala përshëndetëse, Përmes kësaj shkrese të përmbledhur në pika të shkurtëra Kryqi i Kuq i Kosovës Dega në Skenderaj ju informojmë se aktivitetet gate muajit Tetor si muaji i solidaritetit në vepër, qëllim kryesor ka që të ndihmohen familjet me kushte të rënda ekonomike, që të cilën vullnetaret e kryqit të kuq dega në Skenderaj në vazhdimësi po e përmbushin si mision, duke dalë në terren dhe duke ndihmuar këto familje. Gjate këtij muaji qytetarët mobilizohen me mundësitë e tyre për të mbështetur familjet me kushte të rënda ekonomike, andaj në këtë aksion kërkojmë edhe nga ju dhe përmes juve që në baze të mundësive t'i ndihmoni këto familje, pasi që si përfaqësues të qytetareve i njihni brengat dhe kushtet e tyre me të cilat ballafaqohen. Po ashtu këtij aksioni ftojme që t'i bashkëngjiten edhe bizneset e Komunës sonë dhe njerëzit e vullnetit të mirë. Shoqata jone fokus të veçante për të 'u dalë në ndihmë ka rreth 60 të moshuar të cilët jetojnë pa përkujdesje familjare, me kushte të rënda jetësore, dhe për t'i ndihmuar ata kanë nevojë për ushqime, veshmbathje, shtroje e mbuloje, mjete financiare e tjera. Ndihmat e juaja mund t'i sillni vete në lokalet e Kryqit të Kuq në Skenderaj, si dhe mjetet financiare në llogarinë bankare KK NLB 1707001011225205.

Kryesuesja; E hap debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (26) vota për, (0) kundër dhe (7) abstenim, përkrahjet Informatë lidhur me muajin e solidaritetit 01-31 Tetor 2024.

Vazhdojmë me piken 8 të rendit të ditës:

-Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme, fjalën ja kaloj;

Afrim Kabashi-NSD: Për Drejtorin për Shërbime Publike; Drejtor a keni parapa në projektin e ndriçimit publik në përfshirjen për banoret e lagjes nr.2 rruga 28 Nëntori konkretisht 3 rrugë që nuk kanë ndriçim tek lagja Vojvoda? Për Drejtorin e Bujqësisë; Drejtor jemi në fazën e mbjellurav vjeshtore, dhe ju si drejtorat a keni parapa me ndonjë masë përkrahje për bujqit kultivues të kulturës së grurit?

Kryesuesja: fjalën ja kaloj:

Drejtori i DSHP-së, Alban Shala; Ne veç kemi fillua me realizimin e projektit ndriçimi publik në tërë territorin e komunës së Skenderajt disa ekipe janë në fshatra, për momentin janë në Rezallë dhe në Klinë të Mesme, dhe në qytet në lagjen 3, pasi të përfundojnë lagjen 3, kanë me vazhdua në lagjen 2, edhe të lagja vojvoda.

Drejtori i DBPZHR-së, Behxhet Maliqi; Fjala përshëndetëse, ne nuk kemi në planifikim që me i subvencionua bujqit me grurë, sepse këtë subvencion e bënë ministria.

Kryesuesja: fjalën ja kaloj:

Naser Bajraktari-IDEAL: Për Drejtorin për shërbime Publike: Drejtor pse janë ndërpre shërbimet e varrimit në komunën tonë? Për drejtorin e shëndetësi: Pse nuk është bërë pagesa për nëna lehona për fëmijët e porsalindur?

Kryesuesja: fjalën ja kaloj:

Drejtori i DSHP-së, Alban Shala; Naser shërbimet e varrimit nuk janë ndërpre na e kemi marrëveshjen me BIK-un, dega në Skenderaj për mbulimin e shpenzimeve të varrimit dhe për qdo muaj vjen fatura prej BIK-ut, dhe mbulohen shpenzimet

Kryesuesja: fjalën ja kaloj:

Naser Bajraktari-IDEAL: Drejtorë shpenzimet e varrimit kohëve të fundit nuk janë tu u pagua, së kompania që i qel varret nuk është tua ardh unë ti them me emra dhe me mbiemra, së që dy muajt të fundit, dhe verifikoj këto drejtor së është e vërtetë?

Kryesuesja: fjalën ja kaloj:

Drejtorit të DBF-së, Ismet Aliu: Një përgjigje të shkurt, gjatë vitit aktual ne kemi vështirësi në buxhet për arsye së janë marruar nga përmbaruesi privat së edhe në subvencione ka vonesa, po me gjithatë ato obligime kanë me u krye, po kemi mungesë nëpër kode buxhetore dhe mundet me jetë ndonjë faturë e pa paguar, dhe ne i kemi parapa këto shpenzime dhe kemi me i krye këto shpenzime.

Drejtori i DUMA-së Shahin Tahiri: Fjala përshëndetëse, është bërë një pjesë e pagesës për fëmijët e porsalindur, pjesën tjetër planifikojmë më bë në fund të vitit.

Kryesuesja: fjalën ja kaloj:

Abdulla Gashi-IDEAL; Pyetje për drejtorin e urbanizmit z. Driton Mula: z. drejtor, a ke mundësi me na sqarua se çka keni ndërmarre tek një rrugë e cila quhet “Shaban Hasani”, që lidhet me shtëpinë e z. Sali Berisha në Turiqec, kjo familje është në gjendje shume te rende ekonomike. Për tu lidhur ne rrugë te asfaltuar duhet te kalojnë neper balte, qe s’ka mundësi as automjetet me kalua kur ka reshje të shiut apo të bores, e kemi ngritur këtë shqetësim edhe me herët? Pyetjen e dytë dhe tret, e kaloj në seancën e ardhshme, për arsye së krytari nuk gjendet në sallë,

Kryesuesja: fjalën ja kaloj:

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Abdulla e di gjendjen e asaj rrugë ma mirë se tij, jam kanë inxhinier mandatin e kaluar në kompani që e kanë trajtua, ja kanë lan edhe 150m, pa e trajtua para zgjedhjeve, vitin e kaluar e ka ngrit si çështje edhe osmani, dhe gjatë këtij viti këna me trajtua, edhe rrugën të sandukani e këna trajtua 4-5 dite për kullën e sandukanit jemi në diskutim me agjenionin të komplekseve me ndërtua komplet kullën.


Kryesuesja: Me qaq mbyllet kjo mbledhje, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit
Direkcija za Urbanizam i Zaštitu Ambiena
Department of Urban and Environmental Protection

Informatë për Lejet ndërtimore për vitin 2024					
Nr.	Pronari	Lloji i lejes	Nr.protokollit	Data	Shuma totale €
1	Isuf Aliqkaj	Objekt afarist-banesor	06-351/02-0010204/24	21.02.2024	8,413.56
2	Rreze Company shpk	Hangar-depo	06-351/02-0011036/24	28.02.2024	2,902.59
3	Beli Invest shpk	Objekt afarist-banesor	06-351/02-0010852/24	29.02.2024	8,245.45
4	EL Tech Kosova	Objekt afarist-banesor	06-351/02-0010385/24	04.03.2024	18,549.79
5	Andrra Invest LLC - 1	Objekt afarist-banesor	06-351/02-0013066/24	20.03.2024	12,544.68
6	Fidaim Shala	Objekt banimi	06-351/02-0056077/24	22.03.2024	8,963.09
7	Autolarje Meti shpk	Autolarje-Leje e përkohshme	06-350/02-0015158/24	27.03.2024	369.71
8	Omer & Nili Invest Sha	Stacioni me objekte përcjellese	06-351/02-0014756/24	04.04.2024	11,942.90
9	DSHP	Subqendra Likovc	06-351/02-0017831/24	15.04.2024	
10	DSHP	Subqendra Runik	06-351/02-0017823/24	15.04.2024	
11	DSHP	Subqendra Qirez	06-351/02-0017832/24	15.04.2024	
12	Perparim Kadriu	Banim	06-351/02-0014730/24	14.05.2024	1,719.44
13	Asons Invest shpk - 2	Objekt afarist-banesor	06-351/02-0014528/24	20.05.2024	23,444.47
14	NewVision Arbl shpk	Objekt afarist-banesor	06-351/02-0019576/24	24.05.2024	8,967.84
15	ANB & KS- L/02	Objekt afarist-banesor	06-351/02-0017175/24	03.06.2024	23,754.19
16	Arif Mala	Shtepi banimi	06-351/02-0023830/24	19.06.2024	745.89
17	Kabashi Invest	Objekt afarist-banesor	06-351/02-000688/24	21.06.2024	15,572.73
18	Xani Dekor shpk	Banim	06-351/02-0026494/24	08.07.2024	1,039.47
19	Isa shpk PH-Lamella A	Banim	06-351/02-0023367/24	11.07.2024	2,440.88
20	Isa shpk PH-Lamella C	Banim	06-351/02-0023365/24	11.07.2024	1,409.32
21	Valon Spahiu	Fabrikë për prodhimin e gelqerës	06-351/02-0028323/24	11.07.2024	
22	Vllazërit Osmani shpk	Objekt afarist-banesor	06-351/02-0028859/24	12.07.2024	10,310.64
23	Ismet Commerc PH	Banim	06-351/02-0023357/24	15.07.2024	2,576.04
24	Xani Partners shpk	Plotesim-ndryshim	06-351/02-0026490/24	17.07.2024	184.39
25	Mehdi Gjoka Bl	Pompë e derivateve e lokal afarist	06-351/02-0031679/24	17.07.2024	5,118.75
26	Halim Kuliqi	Shtepi malore	06-351/02-0028625/24	22.07.2024	342.85
27	AHB Group	Objekt afarist-banesor	06-351/02-0015724/24	23.07.2024	21,427.33
28	Babaj Project	Banim	06-351/02-0027651/24	24.07.2024	2,269.71
29	DSHP	Qendra e Zjarrfikesve	06-351/02-0033026/24	25.07.2024	
30	ANB & KS- L/05	Objekt afarist-banesor	06-351/02-0029164/24	29.07.2024	26,489.39
31	Azem Bejta	Fabrikë e dyerve e dritareve	06-351/02-0031553/24	30.07.2024	
32	Mimozë Demaku	Depo për ruajtje të pemëve	06-351/02-0037003/24	12.08.2024	168.00
33	QMF	Qendra e mjekesisë familjare	06-351/02-0037609/24	12.08.2024	
34	Drena shpk	Kat shtesë në Objekt afarist	06-351/02-0045768/24	27.09.2024	3,641.88
35	Syla Group	Aneks	06-351/02-0046674/24	02.10.2024	559.99
36	AT & N Group shpk	Objekt afarist-banesor	06-351/02-0048933/24	24.10.2024	55,164.67
TOTALI :					€ 279,279.64

Skenderaj, me 13.11.2024

1 Arkivit

2 Zyrës së Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI KOMUNAL I SHKENDERAJT
SHKENDERAJ

Nr. _____
No. 06-317/01-0002097/64
Data _____
Data 13 11 2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit
Direkcija za Urbanizam i Zaštitu Ambiena
Department of Urban and Environmental Protection

Në bazë të nenit 17 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040/2008, Në bazë të nenit 6, 7, 13, 14, 15, 16, 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje (Gazeta Zyrtare Nr. 14, 20.Gusht 2018), Ligji nr. 08/L-184 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-024 (Gazeta Zyrtare Nr.20/16 Gusht 2023) si dhe Ligji Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Udhëzimin Administrativ Nr.06/2019, neni 63 pika b të statutit të Komunës së Skenderajt Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit si organ profesional, e Informon Kuvendin e Komunës:

INFORMATË PËR PROCESIN E LEGALIZIMIT

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit në procesin e Legalizimit për vitin 2024 që nga 01.01.2024 e deri me datën 14.11. 2024, ka pranuar këto kërkesa:

Total janë 18 kërkesa për Çertifikatë të Legalizimi, prej tyre :

- 1. 14 lëndë janë paisur me Çertifikatë të Legalizimit dhe kanë kaluar në Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë - të përfunduara**
- 2. 32 lëndë të cilat janë në pronë shoqërore, mbesin në listën e pritjes deri në një vendim nga MMPHI**

LËNDË TË PËRFUNDUARA	LËNDË NË PROCES	LËNDË NË PRITJE Qe nga fillimi i procesit të legalizimit.
S+P+2+Nk - 1 lëndë	3 lëndë 2024	P+0 – 5 lëndë
B+P+Nk – 1 lëndë		P+2 – 7 lëndë
P+1+NK – 1 lëndë		B+P+1 – 2 lëndë
P+1- 5 lëndë		B+P+2 – 1 lëndë
P+0 -1 lënd		B+P+4 – 3 lëndë
P+3 – 1 lënd		B+P+NK – 1 lëndë
S+P+2-1 lënd		S+P+1 – 4 lëndë
P+4+Ph -1 lënd		Pa etazhitet – 9 lëndë
P+2+Ph -1 lënd		
P+3+Ph- 1 lënd		

Të gjitha lëndet e lartëcekura janë plotësuar sipas Ligji nr. 08/L-184 Për Ndryshimin dhe Plotësimin të ligjit të legalizimit 06/L-024 .

Datë: 13.11.2024

- 1.x. Arkivit
1.x. Kryesueses se K.K
1.x. Kryetarit të Komunës
Skenderaj 2024





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit
Direkcija za Urbanizam i Zaštitu Ambiena
Department of Urban and Environmental Protection



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA / OPŠTINA / MUNICIPALITY OF SKENDERAJ
NR. NO: 06-350/01-0052078/24
DATA: 13.11.2024

Lista e Lejeve Mjedisore Komunale per Komunen e Skenderajt viti 2024

Nr.	Pronari	Lloji i Lejes	uniref	Shuma e paguar €	Borgjet	Shuma totale €
1	EL TECH Kosova	Leje Mjedisore Komu	26.02.2024	SKU4J333333343Q		2,246.55 €
2	Beli Invest SH.P.	Leje Mjedisore Komu	28.02.2024	SKU4J333333343Q		913 €
3	ANDRRA INVE	Leje Mjedisore Komu	20.03.2024	SKU4J333333343Q		2412.72
4	OMER& NILI IN	Leje Mjedisore Komu	28.03.2024	SKU4J333333343Q		2,380.08
5	ANDRRA INVE	Leje Mjedisore Komu	20.05.2024	SKU4J333333343Q		6,735.90
6	KABASHI INVE	Leje Mjedisore Komu	21.06.2024	SKU4J333333343Q		2,581.23
7	ARIF LUSHTAK	Leje Mjedisore Komu	23.05.2024	SKU4J333333343Q		995.96
8	ANB & KS	Leje Mjedisore Komu	14.05.2024	SKU4J333333343Q		2,353.71
9	Perparim Kadriu	Leje Mjedisore Komu	08.05.2024	SKU4J333333343Q		302.93
10	Isuf Aliqkaj	Leje Mjedisore Komu	20.02.2024	SKU4J333333343Q		1,209.53
11	AHB Group SH.P.	Leje Mjedisore Komu	25.03.2024	SKU4J333333343Q		4,001.14
12	ANB & KS	Leje Mjedisore Komu	29.07.2024	SKU4J333333343Q		2,110.98
13	Valoni Spahiu	Leje Mjedisore Komu	11.07.2024	SKU4J333333343Q		e liruar
14	ISA SH.P.K.	Leje Mjedisore Komu	11.07.2024	SKU4J333333343Q		112.13
15	ISA SH.P.K.	Leje Mjedisore Komu	11.07.2024	SKU4J333333343Q		171.95
16	XANI DEKOR	Leje Mjedisore Komu	12.07.2024	SKU4J333333343Q		54.43
17	VLLAZERIT OS	Leje Mjedisore Komu	12.07.2024	SKU4J333333343Q		1,103.03
18	ISMET I. MUST	Leje Mjedisore Komu	15.07.2024	SKU4J333333343Q		204.08
19	MEHDI GJOKA	Leje Mjedisore Komu	17.07.2024	SKU4J333333343Q		460.00
20	BABAJ PROJEC	Leje Mjedisore Komu	24.07.2024	SKU4J333333343Q		330.00
21	AZEM BEJTA	Leje Mjedisore Komu	31.07.2024	SKU4J333333343Q		e liruar
22	SYLA GROUP	Leje Mjedisore Komu	30.08.2024	SKU4J333333343Q		8,294.63
23	SHALA COMPA	Leje Mjedisore Komu	08.10.2024	SKU4J333333343Q		868.30
24	DRENA SH.P.K.	Leje Mjedisore Komu	27.09.2024	SKU4J333333343Q		493.85
						37,923.01 €

Drejtoria per Urbanizem dhe mbrojtje te ambientit raportin per numrin e lejeve mjedisore komunale deri me 13.11.2024

Drejtori

Idn. Driton Muraj
Skenderaj, 13.11.2024



Pyetjet dhe kërkesat e anëtareve për ekzekutivin e Komunës, Tetor 2024

Pyetje për z. Fadil Nura:

1. A ka mundësi te na tregoni sa është vlera e projektit të Bibliotekës/Muzeut që ka nis të ndërtohet?
2. A ke ndonjë sqarim me konkret sa i përket fabrikës në Polac, a pritet me vazhdua ndërtimi apo gjithçka ka marrë fund rreth saj?
3. Z. Nura, a ke mundësi me u përgjigje se kur do t'i filloni punimet me liqenin artificial në Polac që e ke premtua gjatë fushatës zgjedhore?

Abdulla Gashi-IDEAL

Krekës: Drejtorisë së Inspeksionit.

Edhe pse jam në dijeni për kompetencat e komunës mbi rrugët regjionale në emër të qytetarëve kam një krekës.

Kërkesë për sinjalizimin e rrugës, në Klinë të Mesme, pikërisht tek rrethi.

Në mungesë të sinjalizimit në këtë pjesë të rrugës, brenda këtij viti kanë ndodh shumë aksidente. Qytetarëve kjo ju ka kushtuar me shëndetin e tyre.

Un e kam vlerësuar si urgjente për te ndërhyre në këtë pjesë të rrugës.

I nderuar drejtor Valon Haliti lus nga ju që të bëni presion në ministrinë përkatëse që të zgjidhet ky problem.

Lus për mirëkuptim,

Ali Lutfiu-PDK

-
1. Pyetje Për Drejtorin për Shërbime Publike Alban Shala, Drejtor a ka mundësi te na njoftoni projekti për ndriçim publik i realizuar në Polac a është projekt I kryer apo do te vazhdoje, pasi që sipas punëve te kryera, janë kryer vetëm ndriçimi në rrugët kryesore, ndërsa rrugët anësorë fare nuk janë konkretizuar punimet!
 2. Pyetje për Drejtorin për Urbanizëm Driton Mula, Drejtor a mund te na njoftoni konkretisht a keni ndonjë afat apo plane te caktuar në zgjidhjen e çështjes kanalizimit në pjesën e lagjes te xhamisë në Polac, premtim nga ana e juaj për zgjidhje te problemit që nga viti 2022?

Fotot tregojnë gjendjen faktike në teren...:

Afrim Kabashi-NSD





Për: Drejtorin e Drejtorisë Komunale të Arsimit, z. Kastriot Duraku

Isha shumë i shqetësuar për raportimet e fundit në lidhje me çështjen e edukatës seksuale në shkollat, të cilat gjenden në Doracakun për Mësues për Edukimin seksual dhe shëndetin riprodhues (Klasa I-V), të cilin e lexova në faqen zyrtare të MASHT-it, ku gjetjet e mia ishin edhe më shqetësuese sesa raportimet në media.

E dimë mirë që Edukata Seksuale nuk është lëndë e veçantë në ciklin fillor (I-V), por këto tema trajtohen në orët mësimore të lëndëve Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe mjedisi, dhe Edukata fizike, sportet dhe shëndeti. Për mua si prind, qytetar dhe si këshilltar komunal, këto tekste janë shqetësuese, degjeneruese, denigruese dhe fyese për shoqërinë tonë, shtu këtu moshën delikate dhe fragjile të tyre. Pyetja ime është, a është duke u zbatuar ky doracak nga mësimmshënësit dhe se a trajtohen këto tema në shkollat tona?

Mentor Mehmeti – PDK

1. Pyetje për drejtorin e urbanizmit a ka mundësi që të rregullohen 2 puseta të kanalizimit në fshatin Kline të Poshtme sepse ekziston rreziku potenciale që të mbyllen gypat e kanalizimit të cilat puseta gjenden prapa qendrës së Kontrollimit Teknik ku rrezikohet të mbyllen mbi 2 km kanalizim?

2. Është ngritur shqetësim nga qytetarët e Skenderajt për dëmtimin e parkut Idriz Rreci, shqetësim të cilin e kam edhe unë sepse ka pasur mundësi që këto 2 objekte të ndërtohen në anën e kundërte - përballë stacionit të autobusëve tregun aktuale - por ndoshta kjo pjesë po ruhet për interesa të ekzekutivit ndërtim i lartë?

Musa Fazliu-IDEAL